# PLANI VJETOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE "TURGUT OZAL" 2026-2027

TURGUT OZAL
INSTITUCIONET ARSIMORE



Shkolla 9-vjeçare jopublike "Turgut Ozal" Durrës
Datë: 08.10.2026
Nr. Prot.: 401-045/1

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E ARSIMIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**
**ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**

**Prot.** 2471 **Durrës, më** 29/09/**2026**

**Lënda : Shqyrtim/miratim i dokumentacionit të Institucionit Arsimor për vitin 2026-2027**

**Drejtuar : Shkollws 9-vjeçare jopublike "Turgut Ozal"**

Në respektim të Urdhërit nr.31, datë 28.01.2020, "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë", ZVA Durrës konfirmon shqyrtimin e dokumentacionit të IA-së për vitin 2026-2027, respektivisht si më poshtë:

- Planin Vjetor të shkollës
- Rregulloren e shkollës
- Plani i veprimtarive jashtwshkollore

Pas shqyrtimit të tyre ZVAP shprehet si më poshtë:

**Dokumentacionet e sipërcituara janë hartuar konform udhëzimeve në fuqi dhe përmbushin të gjitha parametrat për miratim nga ZVAP dhe zbatim për vitin shkollor 2026-2027.**

**DREJTORE**

**Amarilda THËRMIJA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT**
**AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS**
**ZYRA VENDORE ARSIMORE DURRËS**

TURGUT OZAL INSTITUCIONET ARSIMORE

# SHKOLLA 9- VJEÇARE JOPUBLIKE

# "TURGUT OZAL" DURRËS

# PLANI VJETOR

## Viti shkollor 2026– 2027

**Drejtori i shkollës**
**Suada KROJ**

**Miratoi:**
**Drejtori i Zyrës Vendore Arsimore**
**Amarilda THËRMIJA**

Nr. 2122 Prot
Dt. 16.09.26

## 1. Hyrje

- Institucioni arsimor jopublik “Turgut Ozal”, Kopshti, shkolla 9-vjeçare, dhe e Mesme janë pjesë e kompleksit arsimor “TURGUT OZAL”, i cili u vu në funksionim të plotë në muajin Janar te vitit 2002 me Vendim Nr. 24 datës 28.01.2002, të Këshillit të Ministrave (8-Vjeçare). Kopshti: 6 Qershor 2015 me Urdhërin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës Nr. 174, datës 16.06.2005 dhe E Mesme: me Urdhërin Nr. 235, datës 18.07.2005.

- Ky kompleks, përbëhet nga një bllok ndërtesash te veçanta (3 gjithsej) që ndërlidhen me njëra tjetrën funksionalisht. Secila prej tyre disponon mjediset e mjetet e nevojshme sipas destinacionit përkatës, për të zhvilluar normalisht veprimtarinë mësimore dhe edukative me nxënësit. Në mjediset e këtyre ndërtesave kryejnë veprimtaritë mësimore edukative: **1.-**kopshti i fëmijëve, dhe shkolla 9-vjeçare, cikli i ulët (kl.1-5), **2**.- Cikli i mesëm i ulët (kl.6-9) **3.-** Cikli i Mesëm lartë (kl. 10-12)

- Blloku i ndërtesave të kompleksit është konceptuar e realizuar sipas një projekti të parashikuar me struktura moderne, që përmbajnë të gjitha ambientet dhe mjediset e nevojshme, të plotësuara me mjete sipas kërkesave të infrastrukturës arsimore bashkëkohore. Kompleksi është funksional për të përballuar veprimtarinë mësimore edukative, me një kapacitet prej rreth 1000 nxënësish. Blloku arkitektonik ka 3 ndërtesa që lidhen me njëra tjetrën përmes korridoreve, shkallëve, ashensorëve: (ndërtesat janë 5-katëshe. Të gjitha ambientet e brëndshme e të jashtme të Kompleksit Arsimor disponojnë kushte optimale (mjedise me hapësira të nevojshme, pajisje teknologjike moderne, mjete didaktike, kabinete laboratorë, salla të ndryshme etj.), për realizimin sasior e cilësor të procesit mësimor-edukativ. E tërë infrastruktura e instaluar, është e plotësuar në mënyrë të harmonizuar në përshtatje me destinacionin përkatës. Ajo i pergjigjet mjaft mirë gjithë kërkesave për zhvillimin normal e me nivel të lartë cilësor e shkencor, të veprimtarisë mësimore edukative, që përmban kurrikula lëndore dhe programi mësimor i shkollave parauniversitare, sipas standarteve më të përparuara. Hapësirat e mëdha dhe infrastruktura japin mundësi për zhvillimin normal të mësimdhënies.

- Në përbërje të kompleksit janë sallat, të cilat përmbajnë ambientet social-kulturore e mediatike (salla shfaqjesh, konferencash, panaire, kinemaje, biblioteka etj.) Në katin e parë funksionon salla (palestra) me dimensione olimpike për zhvillimin e veprimtarive sportive si: lojëra sportive me top, aerobi, fitnes, gjimnastikë etj.)

- Në mjedisin e brendshëm, ndërtesat e shkollës kanë në dispozicion një numër të konsiderueshëm ambientesh mësimore plotësuese për punë praktike konkretizuese, eksperimente praktike etj. si: auditore, klasa, laboratore, kabinete, salla kinemaje, dhoma e mjedise të veçanta për vizita e mjekim, për shërbimin psikologjik, për seanca përgatitore të veprimtarive si: olimpiada, konkurse dhe aktivitete të ndryshme social-kulturore. Këto dhe shumë anekse të tjera, janë të pajisura me të gjitha mjetet e nevojshme sipas funksioneve të caktuara. Infrastruktura mësimore moderne i është përshtatur dhe mbështet plotësisht, realizimin e procesit mësimor - edukativ, sipas grupmoshave përkatëse duke synuar realizimin e objektivave sipas standarteve evropiane. Duke e vlerësuar infrastrukturën mësimore si një faktor mjaft të rëndësishëm të sistemit arsimor bashkëkohor.

- Drejtoria e shkollës mbështet në vazhdimësi, modernizimin e mëtejshëm të procesit mësimor përmes futjes së metodave dhe elementëve të teknologjisë së lartë (tabelat elektronike, smart-board, pajisjeve dixhitale, etj.). Njëkohësisht, kjo infrastrukturë ndihmon mësuesit në realizimin e programeve mësimore me nivel të lartë shkencor e pedagogjik, duke krijuar periodikisht kushte optimale për asistencë pedagogjike e metodiko-shkencore, për trajnime e kualifikime në bashkëpunim me institucionet qëndrore, me specialistë të kualifikuar nga vendi e jashtë.

## 2. PROCEDURA E HARTIMIT TE PLANIT

- Bazuar në Rregulloren për IAP neni 51 për Planin Vjetor të Shkollës, grupi i punës i përbërë nga mësues, prindër dhe nxënës ka hartuar planin vjetor për vitin shkollor 2026-2027.

Për hartimin e Planit Vjetor të Punës për vitin shkollor 2026– 2027, të shkollës 9-vjeçare jopublike "Turgut Ozal", u sigurua paraprakisht formimi i grupit qëndror të punës, si dhe nëngrupet që mblodhën dhe realizuan përpunimin e të dhënave, si dhe rezultatet e këtyre të dhënave. teknike. Referimi e krahasimi u bë në bazë të dokumentacionit zyrtar përkatës i cili paraqitet në institucionet arsimore drejtuese qëndrore.

Gjithashtu u realizua bashkëpunimi i nevojshëm dhe partneriteti i domosdoshëm me faktorët e interesuar të poshtëshënuar:

- Drejtoria Përgjithshme e Turgut Ozal. (DPTO).
-Anëtarët e stafit drejtues të shkollës së mesme si dhe sektorët: sekretari, arkiv, ekipet kurrikulare.
- Përgjegjësit e departamenteve të lëndëve mësimore.
- Anëtarë të bordit të shkollës, këshilli i prindërve, këshilli i mësuesve.
- Përgjegjësit e sektorëve (financë, teknikë, transport etj)

## 3. ANALIZA E GJENDJES

- Pas përfundimit të vitit shkollor 2025-2026, Drejtoria e shkollës zhvilloi analizën e përgjithshme vjetore me stafin mësimdhënës, duke bërë vetëvlerësimin e cilësisë së punës, mbi bazën e arritjeve dhe plotësimit të objektivave në procesin mësimor edukativ.

Kjo analizë u përqëndrua kryesisht në diskutimin e rezultateve konkrete të arritura në të gjithë komponentët përbërës të procesit mësimor - edukativ, krahasimit të rezultateve për secilën lëndë, të veprimtarisë studimore-shkencore, social-kulturore, të nivelit të përfaqësimit të nxënësve në konkurse, olimpiada dhe aktivitete të ndryshme, në shkallë lokale, kombëtare etj. të krahasuara me rezultatet e vitit të kaluar.

Paraprakisht, analizat dhe diskutimet janë zhvilluar mbi bazë klasash paralele dhe me metodën e vetëvlerësimit të punës individuale dhe asaj bashkërenduese, duke krahasuar rezultatet e arritura dhe objektivat kryesore të marra për secilën lëndë mësimore. Kjo analizë u thellua krahasimisht në raport me objektivat e përgjithshme. Bazuar në të dhënat krahasuese të treguesve kryesorë të punës mësimore edukative, të kontrollit e monitorimit gjithëvjetor nga drejtoria, inspektimi i jashtëm, anketimit me mësues, nxënës prindër, u bë evidentimi dhe arsyetimi i shkaqeve e i faktorëve për disa mangësi të vërejtura, për plotësimin e të cilëve në vitin shkollor në vazhdim, u përcaktuan detyra të veçanta me plan-veprimi për ndjekjen, zbatimin deri në realizimin e plotë të tyre.

Në analizën vjetore të punës, krahas konkluzioneve përfundimtare, u përcaktuan detyrat dhe objektivat kryesore të punës mësimore edukative, ndryshimet e nevojshme në përmbajtje dhe infrastrukturë që do të zbatohen **për vitin e ri shkollor 2026-2027** të pasqyruara më poshtë:

**A) Ndjekja e shkollës:**

**1. Numri i përgjithshëm i klasave dhe i nxënësve – viti akademik 2025- 2026**

Në shkollën 9- vjeçare (kl.1-9) aktualisht funksionojnë gjithsej **22** klasa, prej të cilave**: (klasa 1-klasa 5)** gjithsej **13 klasa** . Numri i tyre për secilin paralel është: (kl.të 1.ra -3 klasa), (kl.II.ta-3 klasa), (kl.3.ta-3 klasa) ,(kl.4.ta-2 klasa), (kl.5.ta-2 klasa). Ndërsa**, (**nr.i kl**.** 6-9) është **9** klasa dhe në secilin paralel janë: kl.të VI.ta-**2**, kl.të VII.ta**-2**, kl.VIII.ta-**2** dhe kl.të IX.ta-**3**).

Numri i përgjithshëm është **463** nxënës **(220vajza).** Klasat (1-5) kanë 269nxënës nga të cilat 139 janë vajza ndërsa, klasat (6-9) kanë gjithsej 194 nxënës me 100 vajza.

**Arsimi Fillor** – (kl.I- V)

| EMERT. | GJITHSEJ Kl. (1-9) | | CIKLI I ULET.(1-5) | | KL. I | | KL. II | | KL. III | | KL. IV | | KL. V | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F |
| NR. I PËRGJ. I NXËNËSVE | 463 | 20 | 269 | 139 | 57 | 19 | 58 | 27 | 61 | 33 | 44 | 21 | 49 | 20 |
| NR .I KLASAVE | 22 | | 13 | | 3 | | 3 | | 3 | | 2 | | 2 | |

**Cikli i Mesëm i Ulët** – (kl.VI-IX)

| EMERTIMI | GJITHSEJ | | KL. VI | | KL. VII | | KL. VIII | | KL. IX | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F |
| NR . I NXËNËSVE | 194 | 100 | 46 | 23 | 42 | 25 | 47 | 26 | 59 | 26 |
| NR. I KLASAVE | 9 | | 2 | | 2 | | 2 | | 3 | |

Sipas tabelës të paraqitur më sipër rezulton se shkolla **9-vjeçare** përbëhet nga një numër i përgjithshëm, prej 463 nxënës (**220femra).** Stafi mësimdhënës (përfshirë dhe atë drejtues) përbëhet nga **42** mësues, prej të cilëve, **37 femra.** Duke iu referuar totalit të shifrave të paraqitura më sipër 463 nxënës dhe 42 mësues), rezulton afërsisht një shpërndarje ngarkese në raportin: **1 mësues për 11 nxënës**.

**2. Përqindja e mungesave kundrejt të gjitha orëve mësimore**

| Nr. | Treguesit | Shkolla 9-vjeçare |
|---|---|---|
| 1. | Numri i klasave | 22 |
| 2. | Numri i nxënësve | 463 |

| | | |
|---|---|---|
| 3. | Përqindja e mungesave (2025-2026) | 1.50% |

**Anët e forta**:

1. Përdorimi i teknologjisë në funksion të procesit mësimor dhe aktiviteteve.
2. Komunikim i vazhdueshëm dhe bashkëpunim i efektshëm me familjen në funksion të përparimit të nxënësit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor.

**Anët që kanë nevojë për përmirësim**:
(Në përmirësim të mëtejshëm, për përsosje)
1-Rritja e pranisë së nxënësve në mësim në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë vitit, në të gjitha lëndët mësimore.

**B) Aspekti social:**

Nxënësit e shkollës "Turgut Ozal' Durrës përgjithësisht vijnë nga familje me arsim të lartë dhe të mesëm. Numri i familjeve që marrin ndihmë ekonomike është minimal. Nxënësit vijnë nga qyteti i Durrësit dhe rrethinat e qytetit.
Janë 5 nxënës vetëm me një prind.

**Anët e forta:**

1. Angazhimi i stafit mësimdhënës dhe i Zyrës së Orientimit dhe Karrierës në ofrimin e një mbështetjeje të vazhdueshme për nxënësit, si në aspektin akademik ashtu edhe në atë personal.
2. Zhvillimi i aktiviteteve social-kulturore me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, që kontribuojnë në ndërtimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe bashkëpunues në shkollë.
3. Integrimi i platformës APERTURE në kurrikulën me bazë shkolle, si një mjet efektiv për edukimin e vlerave dhe zhvillimin e kompetencave sociale të nxënësve.

4. Mbështetja emocionale dhe psikologjike që ofrohet nga shërbimi psiko-social, qe te përballojnë sfidat dhe të krijojnë klimë pozitive në klasë.

**Anët që kanë nevojë për përmirësim**:

1- Pjesëmarrje më e ulët se pritshmëritë në disa klube në ciklin AMU të ngritura në shkollë.

**C) Arritje lëndore:**

1- Nota mesatare vjetore: 8.9

**2-** Përqindja vjetore e kalueshmërisë: 100 %

**3-** Nota mesatare në provimet PKAB: 9.08

**4-** Diferenca ndërmjet notës vjetore për lëndët Gjuhë e huaj e parë, Anglisht, Matematikë dhe Gjuhë Shqipe krahasuar me notat e këtyre lëndëve në provimet PKAB: 0.50

**5**-Pikët mesatare të nxënësve në vlerësimin e arritjeve të nxënësve, në arsimin fillor (VANAF) 50.94

Pas përfundimit të vitit shkollor 2025-2026, Drejtoria e shkollës zhvilloi analizën e përgjithshme vjetore me stafin mësimdhënës (për ciklin e ulët dhe të lartë), duke bërë vetëvlerësimin e cilësisë së punës, mbi bazën e arritjeve dhe plotësimit të objektivave në procesin mësimor edukativ.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa 5 | 49 | 20 | 49 | 20 | 100% | 9.55 |
| Klasa 6 | 46 | 23 | 46 | 23 | 100% | 8.95 |
| Klasa 7 | 42 | 25 | 42 | 25 | 100% | 8.7 |
| Klasa 8 | 47 | 26 | 47 | 26 | 100% | 8.6 |
| Klasa 9 | 59 | 26 | 59 | 26 | 100% | 8.5 |

**Rezultatet në Provimin e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve në Arsimit Fillor (VANAF)**

| Viti Shkollor | Pikët mesatare të nxënësve në VANAF |
|---|---|
| 2025-2026 | 50.94 |

**5. Diferenca ndërmjet notës mesatare të shkollës, në provimet e gjuhës së huaj (Anglisht), të Gjuhës Shqipe dhe të Matematikës, me notën mesatare të këtyre lëndëve (së bashku), në klasën e 9-të.**

| Viti shkollor | Lënda | Nota mesatare vjetore e nxënësve | Nota mesatare e PKAB | Diferenca në çdo lëndë |
|---|---|---|---|---|
| 2025-2026 | Matematikë | 8.53 | 9.1 | 0.57 |
| | Gjuhë shqipe | 8.39 | 8.32 | 0.07 |
| | Gjuhë e Huaj (Anglisht) | 8.95 | 9.81 | 0.86 |

**Anët e forta**:

1- Rritje e notës mesatare për lëndët anglisht, gjuhe shqipe dhe matematikë në provimet PKAB krahasuar me notën mesatare të nxënësve.

2- Pjesëmarrja në aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe olimpiada të organizuar nga Qëndra Kulturore e Fëmijeve, dhe nga Zyra Vendore Arsimore, Durrës.

3- Pjesëmarrja në olimpiada ne rang qyteti si dhe në olimpiada kombëtare.

4- Qëndrueshmëri e kalueshmërisë 100%.

5- Zhvillimi i aktiviteteve mbështetëse për nxënësit me vështirësi në të nxënë, nxënësit e kthyer nga emigracioni dhe për ata me prirje të veçanta, edhe jashtë orarit mësimor.

6- Zbatimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies me fokus tek nxënësi, për të nxitur përvetësimin e qëndrueshëm të kompetencave.

**Anët që kanë nevojë për përmirësim:**

1-Arritje më të larta në konkursin e matematikës të organizuar nga QKF dhe ZVA si dhe arritje më të larta në konkursin kombëtar të gjuhës shqipe të organizuar nga MA.

**D) Etika dhe sjellja**

Nxënësit e shkollës sonë kanë zbatuar Rregulloren e Brendshme të shkollës dhe kanë patur marrëdhënie të mira, të rregullta, miqësore dhe korrekte me njëri-tjetrin. Kanë respektuar mësuesit, shokët e shoqet, kanë ruajtur mjedisin dhe nuk kanë dëmtuar orenditë e shkollës. Gjithashtu, gjatë mësimit, në pushim, vërejmë vetëkontroll e sjellje të mira të nxënësve. Veshja e tyre ka qënë sipas kodit të veshjes të rregullores së shkollës. Gjatë vitit shkollor komisioni i etikës dhe sjelljes ka marrë në shqyrtim të gjitha rastet që janë paraqitur. Nxënësit kanë zbatuar rregulloren për sa i përket veshjes së uniformës në shkollë. Gjatë vitit shkollor janë referuar 2 ankesa në Komisionin e Etikës dhe Sjelljes.

**Anët e forta**:

1- Shkolla ofron shërbime funksionale psiko-sociale dhe mjekësore për mbështetjen e nxënësve.
2- Nxënësit dallohen për sjellje pozitive dhe respekt të vazhdueshëm, si në ambientet e shkollës ashtu edhe jashtë saj.
3- Zbatimi i rregullores së shkollës nga ana e nxënësve është i qëndrueshëm, ndërsa marrëdhëniet e tyre me bashkëmoshatarët dhe stafin janë pozitive dhe të respektueshme.
4- Nxënësit janë përfshirë me dëshirë në kryerjen e detyrave si nxënës dhe si qytetarë.
5- Komunikimi dhe bashkëpunimi ndërmjet mësuesve kujdestarë dhe prindërve zhvillohet në mënyrë efektive dhe të vazhdueshme.

**Anët që kanë nevojë për përmirësim:**

1- Ndjekja e vazhdueshme e edukimit në komunikim, në raste të veçanta kur vërehet përdorimi i shprehjeve jo të përshtatshme në mjedisin e klasës e të shkollës.

**E) Mësuesi**
1- Numri i mësuesve gjithsej: 42.
**2**- Stafi mësimdhënës përbëhet nga mësues me përvojë të konsoliduar në fushën e mësimdhënies.
**3**- Mësuesit kujdestarë dhe mësuesit e lëndëve kanë pasur kontakte të rregullta me prindërit /kujdestarët ligjorë për vijimësi të rregullt.
**4**- Në fillim të vitit shkollor si dhe përgjatë tij stafi pedagogjik mori pjesë në trajnime dhe seminare të ndryshme fizikisht ku u pajisën me certifikata me kredite dhe pa kredite.
**5**- Janë zhvilluar trajnime nga trajnues të huaj dhe vendas që kanë eksperiencë në fushën e mësimdhënies.

**Anët e forta**:

1- Bashkëpunimet e krijuara me partnerë të ndryshëm kanë mundësuar përfshirjen aktive të stafit pedagogjik në konferenca dhe seminare profesionale në fushën e arsimit dhe edukimit.

2- Niveli arsimor i duhur i mësimdhënies, paraqitja e rregullt dhe në kohë në mësim e mësuesve, marrëdhëniet e drejta me drejtuesit, me nxënësit dhe me prindërit e tyre, përgjegjësia e lartë për detyrën dhe shembulli pozitiv në punë e sjellje për nxënësit bëjnë që shkolla jonë të ketë shumë anë të forta në këtë aspekt.
3-Mësuesit bashkëpunojnë në mënyrë aktive duke shkëmbyer përvoja, ndarë sfida dhe arritje, si dhe duke zbatuar me përkushtim detyrat e përcaktuara nga drejtoria.
4- Mësuesit zbatojnë me korrektësi kurrikulën e re me bazë kompetencat.
5- Mësuesit përdorin metoda e teknika bashkëkohore në mësimdhënie.
6-Teknologjia është e integruar në mënyrë efektive në mësimdhënie falë aftësive të mira digjitale të mësuesve.

**<u>Anët që kanë nevojë për përmirësim</u>**:

1- Mësues me ngarkesë mësimore në dy cikle.

**F) Pjesëmarrje në projekte me fondacione, Olimpiada, konkurse dhe gara të ndryshme**

Rezultatet pozitive dhe arritjet e konsiderueshme në pjesëmarrjen e nxënësve tanë në veprimtari të ndryshme shkencore si dhe sociale në shkallë lokale, kombëtare e ndërkombëtare, jo vetëm kanë fituar qëndrueshmëri, por ato çdo vit kanë njohur rritje progresive. Gjatë vitit shkollor 2025-2026, nxënësit përfaqësues të shkollës "Turgut Ozal'' në këto aktivitete, kanë fituar çmime të ndryshme.

**QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE DURRËS**

**Une Këndoj**

**1** Fitues i Çmimit të Parë

**Konkursi i Ansamblit**

1 Fitues i Çmimit të Tretë

**Kampionati i Shahut**

2 Fitues i Çmimit të Tretë

**Konkursi "Unë dhe kompjuteri"**

1 Fitues - Çmimi i Parë,

**Tingujt e Adriatikut**

1 Fitues - Çmimit të dytë

**Olimpiada e Gjuhës Shqipe Faza e dytë**

2 Fitues -Çmimit të Tretë

**Olimpiada e Matematikës QKF**

2 Fitues - Çmimit të tretë

1 Fitues - Çmim nderi

**OLIMPIADA MBARËKOMBËTARE FEST MATEMATIKË**

1 Fitues - Çmimit të tretë

**G) Infrastruktura**

1- Gjendja e godinës shkollore është shumë e mirë, ka ujë të mjaftueshëm, ndërtesa ka ajër, dritë të mjaftueshme dhe ngrohje të mirë.
**2-** Shkolla disponon oborr me hapësira të gjera ku ndodhen dy ambiente sportive.
**3-** Klasat e mësimit, korridorët, kabinetet dhe mjediset e brendshme kanë përmasat dhe hapësirat e duhura sipas standarteve.
**4-** Raporti nxënës-mësues për vitin shkollor 2025-2026 ishte në shifrat 11 me 1.
**5-** Gjendja e pajisjeve shkollore është shumë e mirë. Baza materiale, bankat, dërrasat, tavolinat, raftet, kompjuterat, printerat, aparaturat dhe orenditë e tjera janë të reja, të përshtatshme dhe komode për mësim.
**6-** Kemi në gjendje shumë të mirë 2 laboratorë mësimorë me pajisjet e duhura të shkencës, 2 laboratorë mësimorë të informatikës, një bibliotekë, 2 palestra të mbyllura, ambiente të hapura sportive, 2 salla për klubin e robotikës, dy salla të multimedias me monitor, klasat janë të pajisura me televizor Smart. Në laboratorin e informatikës çdo nxënës ka kompjuterin e vet ku gjithashtu kemi instaluar dhe sistemin e internetit.
**7-** Shkolla zotëron edhe mjete të mjaftueshme didaktike-mësimore në gjendje shumë të mirë për të gjitha lëndët, veçanërisht për gjuhët e huaja (anglisht, turqisht dhe gjermanisht).
**8-** Shkolla disponon bibliotekë e cila u jep mundësinë nxënësve të ulen e të lexojnë brenda ambientit ose të tërheqin libra dhe t'i lexojnë.
**9-** Ndërtesa e shkollës ka numër të mjaftueshëm të tualeteve me ujë të rrjedhshëm dhe të pastra përherë për dy gjinitë, si për nxënës/nxënëse ashtu dhe për personel të shkollës.
**10-** Gjithashtu hapësirat si korridore, oborri i shkollës janë të mjaftueshme për kalimin e kohës së lirë nga nxënësit sipas standarteve.
**11-** Me mjetet që posedojmë, sigurojmë kushte optimale për mësim në të gjitha lëndët.

**<u>Anët e forta</u>**:

1- Klasat janë të pajisura me televizorë smart, duke krijuar mundësi për një mësimdhënie më interaktive dhe bashkëkohore.

2- Shkolla ka laboratorë dhe mjete didaktike bashkëkohore për zhvillimin e lëndëve shkencore dhe sociale.
3- Ka ambiente të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve jashtëshkollore dhe klubeve të ndryshme.

**Anët që kanë nevojë për përmirësim**:

1- Vështirësitë në sjelljen dhe largimin e nxënësve për shkak të infrastrukturës rrugore të dëmtuar dhe ngarkesës së trafikut.

**H) Komuniteti**

Për një mbarëvajtje sa më të mirë të proçesit mësimor i kushtohet një rëndësi e veçantë partneritetit shkollë-familje. Mësuesit kujdestarë mbajnë kontakte të shpeshta me prindërit e nxënësve për t'i informuar ata. Gjatë vitit shkollor organizohen takime me prindërit, në mënyrë që ata të jenë vazhdimisht të informuar për zhvillimin mësimor dhe sjelljen e fëmijëve në shkollë. Prindërit njoftohen për çdo aktivitet apo veprimtari që organizohet nga shkolla dhe janë aktivisht të përfshirë në realizimin e tyre.

**I) Qëndrimi i klientit**

Bazuar në kontaktet e vazhdueshme direkte, mendimet e shprehura në biseda të ndryshme dhe përgjigjet nga pyetësorët e administruar nga shkolla, nxënësit dhe prindërit e tyre shprehin në përgjithësi kënaqësi për cilësinë e shërbimeve që ofron shkolla. Ata vlerësojnë kushtet e favorshme për mësim, disiplinën, rregullin dhe organizimin e punës, si dhe përkushtimin, afërsinë dhe kujdesin e stafit mësimor dhe drejtuesve.

**4. Synimet e shkollës**

**1- Arritja e rezulateve sa më të larta në Olimpiadat Kombëtare e Ndërkombëtare.**

**2- STEM/STEAM dhe të nxënit të bazuar në projekte (project based learning)**

***A. <u>Në Ciklin e Ulët :</u>***

### ○ OBJEKTIVAT

➢ 1.Të rriten pikët mesatare të nxënësve në vlerësimin e arritjeve në arsimin fillor (VANAF) nga 51 pikë për vitin akademik të mëparshëm në 54 pikë.

➢ 2. Të rritet numri i fituesve në Olimpiadën Cogito me dy fitues më shumë, nga 1 fitues cmim i dytë në 3 fitues në cmim të dytë dhe të parë.

### ○ VEPRIMTARITË

*Për objektivin 1*

Për të arritur objektivin e rritjes së rezultateve mesatare në vlerësimet VANAF për nxënësit e klasës së V-të në lëndët e Gjuhës Shqipe, Matematikë dhe Diturisë me të paktën 10% krahasuar me vitin akademik të mëparshëm, do të ndërmerren disa aktivitete konkrete në secilën lëndë:

➢ Aktivitete Krijuese: inkurajimi i shkrimit kreativ dhe krijimin e historive për të zhvilluar aftësitë krijuese në Gjuhën Shqipe.

B. Përdorimi i Mjetëve Mësimore: Përdorimi i materialeve mësimore dhe teknologjike për të ndihmuar në kuptimin e koncepteve matematikore.

C. Grupet e Punës dhe Mësimi Bashkëpunues: Bashkëpunimi mes nxënësve dhe diskutimet e grupuara për zgjidhjen e problemave matematikore.

Ç. Teste të Rregullta të Simulimit: Organizimi i teste të rregullta të simulimit që përgatitin nxënësit për vlerësimet VANAF.

● Përvojat Mësimore në Natyrë:Vizita në parqe vendore, rezervate natyrore, ose kopshte botanikë për të lejuar nxënësit të vëzhgojnë dhe ndërveprojnë me mjediset natyrore, bimësi dhe faunë.

*Për objektivin 2*

Për të arritur objektivin e rritjes së pjesëmarrjes dhe çmimet në Olimpiadën e Cogito do të punohet me një program të veçantë me nxënësit që kanë aftësi dhe prirje në këtë lëndë.

○ **PLANI I VEPRIMTARIVE**

*Për objektivin 1:*

| OBJEKTIVI | VEPRIMTARITË | PËRGJEGJËSIT | AFATI |
|---|---|---|---|
| Të rriten pikët mesatare të nxënësve në vlerësimin e arritjeve në arsimin fillor (VANAF) nga 51 pikë për vitin akademik të mëparshëm në 54 pikë. | Përdorimi i Mjetëve Mësimore: Përdorimi i materialeve mësimore dhe teknologjike për të ndihmuar në kuptimin e koncepteve matematikore. | -mësuesit /Drejtoria e shkollës | Gjatë vitit |
| | Grupet e Punës dhe Mësimi Bashkëpunues: Bashkëpunimi mes nxënësve dhe diskutimet e grupuara për zgjidhjen e problemave matematikore. | -Drejtoria e shkollës, stafi mësimdhënës | Çdo 3-mujor |
| | Teste të Rregullta të Simulimit: Organizimi i teste të rregullta të simulimit që përgatitin nxënësit për vlerësimet VANAF. | -Drejtoria e shkollës | Çdo 3-mujor |
| | Përvojat Mësimore në Natyrë:Vizita në parqe vendore, rezervate natyrore, ose kopshte botanikë për të lejuar nxënësit të vëzhgojnë dhe ndërveprojnë me mjediset natyrore, bimësi dhe faunë. | -mësuesit | Gjatë vitit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| ➢ Të rritet numri i fituesve në Olimpiadën Cogito me dy fitues më shumë, nga 1 fitues cmim i dytë në 3 fitues në cmim të dytë dhe të parë. | Nëpërmjet ushtrimeve individuale e në grupe, nxënesit do të aftësohen në lëndën e matematikës. Përdorimi i materialeve shtesë dhe platformes IXL për praktikimin e ushtrimeve. | -mësuesit | Gjatë vitit |

***B. Në Ciklin e  Mesëm të Ulët***

**Objektivat**

- 1.Të rritet numri i medaljeve të arit dhe argjendit të fituara në konkursin shkencor ASEF "Albanian Science and Engineering Fair" nga 18 vitin e kaluar në 23.
- 2. Të rritet nota mesatare e grup lëndëve të fushës "Shkencat e Natyrës" për klasat e 7-ta nga 8.53 vitin e kaluar në 8.7

***VEPRIMTARITË***

*Për objektivin 1*

3. Integrimi i Teknologjisë: Përdorni teknologjinë dhe burimet online për të lehtësuar hulumtimin dhe shpërndarjen e projekteve shkencore.
4. Ndërlidhja me Komunitetin Shkencor: Nxitja e bashkëpunimin me organizata shkencore lokale dhe universitete për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë projekte më të thella dhe të fitojnë njohuri më të gjera.
5. Organizimi i konkurse shkencore të vazhdueshme në nivel shkollor dhe vendas për të motivuar nxënësit dhe për të ndihmuar në përmirësimin e tyre të vazhdueshëm.
6. Sigurimi i burime shtesë dhe bibliotekën online për të ndihmuar nxënësit në gjetjen dhe përdorimin e materialeve të nevojshme shkencore.
7. Organizmi i debateve të rregullta në klasë mbi temat shkencore duke nxitur nxënësit të argumentojnë dhe të përdorin aftësitë e analizës dhe mendimit kritik në një kontekst të diskutimit.

*Për objektivin 2*

*8.* Evidentimi i nxënësve që hasin vështirësi.

*9.* Përcaktimi i stafit mësimdhënës që do të japë mbështetje për këtë kategori nxënësish.

*10.* Organizimi i orëve mësimore shtesë dhe hartimi i një orari të posaçëm.

*11.* Raportimi në drejtorinë e shkollës në lidhje me ecurinë.

**PLANI I VEPRIMTARIVE**

| OBJEKTIVI | VEPRIMTARITË | REALIZUESIT | AFATI |
|---|---|---|---|
| Të rritet numri i medaljeve të arit dhe argjendit të fituara në konkursin shkencor ASEF "Albanian Science and Engineering Fair" nga 18 vitin e kaluar në 23. | -Integrimi i Teknologjisë: Përdorimi i teknologjisë dhe burimet online për të lehtësuar hulumtimin dhe shpërndarjen e projekteve shkencore. | -Drejtoria e shkollës, stafi mësimdhënës | -shtator 2026 |
| | -Ndërlidhja me Komunitetin Shkencor: Nxitja e bashkëpunimin me organizata shkencore lokale dhe universitete për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë projekte më të thella dhe të fitojnë njohuri më të gjera. | -Drejtoria e shkollës, ekipet lëndore, stafi mësmdhënës | -shtator 2026 - qershor 2027 |
| | -Organizimi i konkurse shkencore të vazhdueshme në nivel shkollor dhe vendas për të motivuar nxënësit dhe për të ndihmuar në përmirësimin e tyre të vazhdueshëm. | -Drejtoria, ekipet lëndore | -shtator 2026- shkurt 2027 |
| | -Sigurimi i burime shtesë dhe bibliotekën online për të ndihmuar nxënësit në gjetjen dhe përdorimin e materialeve të nevojshme shkencore dhe sociale. | -Stafi mësimdhënës | -muaji i shkencave |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | -Organizmi i debateve të rregullta në klasë mbi temat shkencore dhe sociale të zgjedhura, duke nxitur nxënësit të argumentojnë dhe të përdorin aftësitë e analizës dhe mendimit kritik në një kontekst të diskutimit. | -ekipet lëndore, stafi mësimdhënës | -shtator 2026-shkurt 2027 |
| Të rritet nota mesatare e grup lëndëve të fushës "Shkencat e Natyrës" për klasat e 7-ta nga 8.53 vitin e kaluar në 8.7. | -Evidentimi i nxënësve që hasin vështirësi. | Mësuesit e lëndëve | -Shtator 2026-Nëntor 2026 |
| | Përcaktimi i stafit mësimdhënës që do të japë mbështetje për këtë kategori nxënësish. | Drejtoria e shkollës | Tetor 2026 –Nëntor 2026 |
| | Organizimi i orëve mësimore shtesë dhe hartimi i një orari të posaçëm. | Drejtoria në bashkëpunim me mësuesit | Nëntor-Maj 2027 |
| | Raportimi në drejtorinë e shkollës në lidhje me ecurinë. | Drejtoria, mësuesit | Çdo muaj |

## 5.VEPRIMTARITË PËR VËZHGIMIN E ZBATIMIT TË PLANIT VJETOR

| Nr. | Veprimtaria | Afati | Përgjegjësi |
|---|---|---|---|
| **1.** | Organizim dhe monitorim për zhvillimin e mbledhjeve/takimeve mësues-prind-nxënës. | Shtator 2026, Qershor 2027 | Drejtoria e shkollës |
| **2.** | Identifikimi i nxënësve me vështirësi në lëndë të ndryshme dhe analizimi i problematikave të tyre. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Mësuesit lëndorë |
| **3.** | Organizimi mësimeve shtesë dhe monitorimi mbi pjesëmarrjen dhe funksionimin e këtyre orëve suplementare. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Drejtoria e shkollës<br>Mësuesit lëndorë |
| **4.** | Realizim orëve suplementare sipas një plani të detajuar për të përfshirë të gjithë lëndët dhe të gjithë nxënësit për PKAB 2026-2027. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Mësuesit lëndorë sipas planifikimit të drejtorisë |
| **5.** | Analizë e rezultateve të testeve provë të PKAB 2027 dhe informim i prindërve mbi rezultatet. | Shkurt 2027-Maj 2027 | Drejtoria e shkollës<br>Mësuesit e lëndëve<br>Mësuesit kujdestarë |
| **6.** | Prezantimi i Rregullores së shkollës. | Shtator 2026 | Mësuesit kujdestarë |
| **7.** | Përdorimi i ipad në mënyrë efikase nga nxënësit dhe mësuesit. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Drejtoria e shkollës<br>Mësuesit lëndorë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **8.** | Ndjekje ditore e frekuentimit dhe problemeve që mund të paraqesin nxënësit. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Mësuesit kujdestar<br>Drejtoria e shkollës |
| **9.** | Realizim i testeve të kontrollit. | Në fund të tremujorëve | Drejtoria e shkollës |
| **10.** | Komunikim i vazhdueshëm me prindërit në grup ose individualisht për informim të problemeve që paraqiten dhe për përcjellje të informacionit të nevojshëm. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Drejtoria e shkollës<br>Mësuesi kujdestar |
| **11.** | Analizë e arritjeve lëndore për çdo tremujor dhe evidentimi i pikave që kanë nevojë për përmirësim. | Çdo fund tremujori | Drejtoria e shkollës<br>Mësuesit kujdestarë<br>Mësuesit e lëndëve<br>Grupi statistikës |
| **12.** | Organizimi i takimeve të ndryshme me prindër, profesionistë, psikolog etj. ku zhvillohen diskutime, seminare, ide dhe sugjerime. | Çdo muaj | Drejtoria e shkollës<br>Zyra e këshillimit dhe orinetimit<br>Zyra e shërbimit psiko-social |
| **13.** | Monitorimi i muajve të lëndëve. | Çdo muaj | Drejtoria e shkollës<br>Ekipet lëndore<br>Koordinatorët e cilësisë |
| **14.** | Organizimi dhe monitorimi i konkursit të Artit dhe Letërsisë. | Tetor 2026- Nëntor 2026 | Mësuesit e gjuhë letërsisë<br>Koordinatorët e cilësisë<br>Drejtoria e shkollës |
| **15.** | Gjithëpërfshirja masive e nxënësve në projekte, veprimtari plotësuese. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Mësuesi ndihmës i qeverisë së nxënësve, psikologu |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **16.** | Caktimi i grupit të punës për zhvillimin e klubeve shkollore me qëllim nxitjen dhe zhvillimin e aftësive dhe talenteve të nxënësve. | Shtator 2026 – Tetor 2026 | Drejtoria shkollës<br>Zyra e këshillimit dhe orientimit<br>Mësuesit |
| **17.** | Organizimi dhe monitorimi i klubeve shkollore. | Tetor 2026 - Maj 2027 | Drejtoria e shkollës<br>Zyra e këshillimit dhe orientimit |
| **18.** | Takime dhe diskutime individuale dhe në grup me të gjithë nxënësit në zyrën e këshillimit të karrierës, me qëllim nxitjen e nxënësve drejt arritjeve të rezultateve më të larta. | Tetor 2026 - Maj 2027 | Zyra e këshillimit dhe orientimit |
| **19.** | Organizimi i konkurseve lëndore. | Tetor 2026 - Maj 2027 | Drejtoria e shkollës |
| **20.** | Aktivitete edukative, shkencore, artistike, kulturore, sportive gjatë vitit. | Gjatë gjithë vitit shkollor | Drejtoria e shkollës<br>Mësuesit përgjegjës |
| **21.** | Takim me bordin e shkollës dhe qeverinë e nxënësve për të diskutuar ide, mendime dhe sugjerime lidhje me shkollën, mbarëvajtjen e procesit mësimor, si dhe veprimtaritë ekstrakurrikulare. | Tetor 2026 | Drejtoria e shkollës<br>Bordi i shkollës<br>Qeveria e nxënësve |
| **22.** | Zhvillimi i orëve të hapura dhe Peer Observation me qëllim zhvillimin profesional të mësuesve. | Shtator 2026-Maj 2027 | Mësuesit<br>Koordinatorët e cilësisë<br>Drejtoria e shkollës |
| **23.** | Analizë vjetore | Gusht 2027 | Drejtoria |

Sipas programit të miratuar nga Drejtoria e shkollës, përgjegjësit e ekipeve lëndore, në bashkëpunim me koordinatorët akademikë, do të zhvillojnë të shtunën e parë të çdo muaji, sipas specialiteteve, mbledhje analitike, seminare trajnuese, informacione shkencore dhe trajnime metodike. Këto veprimtari do të mbështeten në planin e zhvillimit profesional të brendshëm dhe do të përshtaten vazhdimisht me kërkesat dhe nevojat e stafit.

Qëllimi kryesor i këtyre veprimtarive është përmirësimi i vazhdueshëm i performancës profesionale të mësuesve, forcimi i bashkëpunimit brenda ekipeve lëndore dhe rritja e cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe të nxënit.

## 7. VLERËSIMI I BRENDSHËM I SHKOLLËS

Vlerësimi i brendshëm i shkollës do të realizohet në përputhje me Urdhrin nr. 268, datë 28.08.2020, "Për miratimin e paketës së vlerësimit të cilësisë së shkollës", si dhe duke iu referuar udhëzuesit "Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës", ASCAP, 2020.

Ky proces do të synojë evidentimin e nivelit të cilësisë së shërbimit arsimor, identifikimin e pikave të forta, përcaktimin e fushave që kërkojnë përmirësim dhe hartimin e masave konkrete për rritjen e vazhdueshme të cilësisë së punës së shkollës.

Vlerësimi i brendshëm do të përfshijë të gjithë punonjësit arsimorë dhe stafin mbështetës të shkollës, përfshirë psikologun, punonjësin social, oficerin e sigurisë dhe sekretarin, si dhe të gjitha organizmat e shkollës.

Fushat e vlerësimit

Vlerësimi i brendshëm do të shtrihet në të gjitha fushat e cilësisë së shkollës:

- Drejtimi dhe menaxhimi;
- Cilësia e mësimdhënies dhe e të nxënit;
- Vlerësimi dhe arritjet e nxënësve;
- Mirëqenia dhe sjellja e nxënësve.

Vlerësimi i këtyre fushave do të realizohet në përputhje me kriteret dhe treguesit e përcaktuar në dokumentet përkatëse të ASCAP.

Organizimi i procesit të vlerësimit

Për koordinimin dhe ndjekjen e procesit do të ngrihet grupi qendror i vlerësimit, i përbërë nga administratori i shkollës, nëndrejtorët, kryetarët e ekipeve lëndore, koordinatorët akademikë, përgjegjësit e teknikës dhe administratës, psikologia dhe doktoresha e shkollës.

Vlerësimi do të realizohet në dy nivele:

- në nivel individual, duke përfshirë drejtorin, nëndrejtorët dhe mësuesit;
- në nivel të organizmave të shkollës, duke përfshirë drejtorinë, këshillin e mësuesve dhe ekipet lëndore.

Procesi i vlerësimit të brendshëm do të shtrihet përgjatë gjithë vitit shkollor dhe do të realizohet në bazë të një planifikimi të posaçëm, me qëllim sigurimin e një vlerësimi të vazhdueshëm, objektiv dhe të dokumentuar.

Monitorimi i procesit mësimor

Një rëndësi e veçantë do t'i kushtohet ndjekjes dhe monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit. Në këtë kuadër, stafi drejtues i shkollës, në bashkëpunim me ekipet lëndore dhe koordinatorët  e cilesisë, do të zhvillojë orë vëzhgimi gjatë vitit shkollor.

Vëzhgimet do të synojnë:

- përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së mësuesve;
- evidentimin e praktikave efektive të mësimdhënies;
- identifikimin e nevojave për zhvillim profesional;
- përmirësimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies;
- lidhjen e cilësisë së procesit mësimor me rezultatet e të nxënit të nxënësve.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet monitorimit të mbarëvajtjes së procesit mësimor në fushat dhe lëndët përkatëse, si dhe zbatimit të planifikimeve dhe objektivave të përcaktuara.

Monitorimi i veprimtarisë së përgjithshme të shkollës

Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, gjatë vëzhgimeve dhe monitorimeve periodike do të shqyrtohen edhe aspekte të tjera të veprimtarisë së shkollës. Në mënyrë të veçantë do të monitorohet realizimi i objektivave të përcaktuara në planet edukative, zhvillimi dhe efektiviteti i veprimtarive sociale, kulturore, edukative dhe ekstrakurrikulare.

Gjithashtu, do të vlerësohet bashkëpunimi ndërmjet strukturave të shkollës dhe kontributi i tyre në krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe mbështetës për nxënësit.

Kontrolli i dokumentacionit dhe planifikimit mësimor

Plani i kontrollit do të përfshijë verifikimin e dokumentacionit dhe të proceseve kryesore që lidhen me veprimtarinë mësimore, ndër të cilat:

- planet vjetore dhe planifikimet mësimore;
- ditarët;
- modelet dhe formatet e përdorura;
- metodikat dhe strategjitë bashkëkohore të mësimdhënies;
- përdorimi i mjeteve dhe burimeve didaktike;
- dokumentacioni bazë i "Dosjes së Mësuesit";
- dokumentacioni tjetër pedagogjik dhe administrativ i kërkuar.

Kontrollet do të shërbejnë jo vetëm për evidentimin e përmbushjes së kërkesave dokumentare, por edhe për identifikimin e nevojave për përmirësim dhe mbështetje profesionale.

Monitorimi i shërbimeve dhe sektorëve të shkollës

Për të siguruar efektivitet dhe cilësi në punën drejtuese, organizuese dhe administrative, stafi i drejtorisë së shkollës do të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e detyrave dhe mbarëvajtjen e punës në sektorët dhe shërbimet e ndryshme të institucionit.

Monitorimi do të përfshijë, ndër të tjera:

- shërbimin mjekësor;
- shërbimin psikologjik dhe social;
- higjienën dhe kushtet e mjediseve;
- ushqimin dhe funksionimin e mensës;
- transportin;
- shërbimet IT;

- mirëmbajtjen dhe teknikën;
- shërbimet administrative dhe mbështetëse.

Ky monitorim do të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, duke filluar nga përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor dhe duke vijuar deri në përfundimin e tij.

Rezultatet e vlerësimit të brendshëm do të shërbejnë si bazë për evidentimin e arritjeve, përcaktimin e prioriteteve dhe hartimin e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së punës së shkollës.

## 8. VEPRIMTARITË EDUKATIVE DHE EKSTRAKURRIKULARE

Për realizimin e të gjitha veprimtarive të paraqitura në Planin Vjetor, drejtoria e shkollës, do të sigurojë bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Turgut Ozal, ZVA-Durrës, organet kolegjiale të shkollës, katedrat, mësuesit kujdestarë, si dhe faktorë të tjerë të jashtëm të interesuar.

Për realizimin sa më cilësor të veprimtarive edukative dhe trajnim+kualifikimit të mësuesve, është hartuar një **Plan-Kalendari Akademik** i veçantë për vitin shkollor 2026-2027**,** i miratuar edhe nga Drejtoria e shkollës "Turgut Ozal".

Kalendari Akademik do të zbatohet në përshtatje me synimet, kërkesat e prindërve, nxënësve dhe kushtet e shkollës 9-vjeçare "Turgut Ozal".

Veprimtaritë edukative, social-kulturore, artistike e sportive, do të zhvillohen mbi bazë **klasash paralele** brenda shkollës dhe jashtë saj në rang shkolle brenda e jashtë vendit. Ndërsa grupet e përzgjedhura (funksionojnë mbi bazë klubesh të caktuara) në përfaqësimin e shkollave 9-vjeçare në rang qyteti, do të përgatiten e trajnohen nga mësues specialistë të lëndëve përkatëse. Këto grupe nxënësish do të marrin pjesë në veprimtaritë midis shkollave të Durrësit, si dhe në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, në fushën e shkencave, artit, kulturës, sportit dhe veprimtarive të tjera. Mbi bazën e anketimeve të organizuara nga shkolla me nxënësit sipas dëshirave të shprehura përcaktohen dhe një numër aktivitetesh të ndryshme.

## 9. LEGJISLACIONI

- Ligji Nr. 69/2012 ( i ndryshuar ), datë 21.06.2012 « Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë» i ndryshuar;
- Kodi i Etikës së mësuesit në arsimin parauniversitar publik dhe privat – Miratuar nga MAS- 30 nëntor 2013.
- Urdhri nr 31 datë 28.01.2020 «Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë»
- Udhëzuesi Nr.17, datë 22.07.2024 «Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve »
- Udhëzimi Nr.17, datë5.7.2022, " Për vlerësimin e nxënesve në sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar me udhëzimin nr. 11, datë 26.06.2023, Për një shtesë në Udhëzimin nr 17, datë5.7.2022, " Për vlerësimine nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar".
- Udhëzimi Nr.25, datë 2.8.2013 ( i ndryshuar) «Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve »
- Udhëzimi Nr.26, datë 2.8.2013 «Për përcaktimin e detyrave dhe funksionëve të këshillit të mësuesve»
- Udhëzimi Nr.25, datë 25.07.2018 ( shtesa) «Për ngritjen e bordit të institucionit arsimor »
- Udhëzimi Nr.30, datë 2.8.2013 «Për rregulloren tip të instuticionëve arsimore »
- Udhëzimi Nr.44, datë 21.08.2013 ( shtesa)«Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit»
- Urdhri Nr. 313, datë 20.10.2020 ( shtesa)«Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social »
- Urdhër 600 datë 19.10.2023 për miratimin e '' Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve ne arsimin e mesëm të ulët" ( klasat 6-9)
- Udhëzim nr.14, dt. 10.07.2023 për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e Arsimit Parauniversitar
- Urdhri i Përbashkët për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2026-2027 në sistemin arsimor parauniversitar (Miratimi i Strukturës së Vitit Shkollor 2026-2027 në Sistemin Arsimor Urdhër Nr.110, datë 21.04.2026.)
- Udhëzim i Përbashkët Nr. 15 Datë 18.08.2026 Për Vitin Shkollor 2026-2027 Në sistemin Arsimor Parauniversitar.

- Urdhri nr 31 datë 28.01.2020 «Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë»
- Udhëzuesi Nr.17, datë 22.07.2024 «Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve »
- Udhëzimi Nr.17, datë5.7.2022, " Për vlerësimin e nxënesve në sistemin arsimor parauniversitar", i ndryshuar me udhëzimin nr. 11, datë 26.06.2023, Për një shtesë në Udhëzimin nr 17, datë5.7.2022, " Për vlerësimine nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar".
- Udhëzimi Nr.25, datë 2.8.2013 ( i ndryshuar) «Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë së nxënësve »
- Udhëzimi Nr.26, datë 2.8.2013 «Për përcaktimin e detyrave dhe funksionëve të këshillit të mësuesve»
- Udhëzimi Nr.25, datë 25.07.2018 ( shtesa) «Për ngritjen e bordit të institucionit arsimor »
- Udhëzimi Nr.30, datë 2.8.2013 «Për rregulloren tip të instuticionëve arsimore »
- Udhëzimi Nr.44, datë 21.08.2013 ( shtesa)«Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit»
- Urdhri Nr. 313, datë 20.10.2020 ( shtesa)«Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social »
- Urdhër 600 datë 19.10.2023 për miratimin e '' Udhëzuesit të orientimit për karrierën të nxënësve ne arsimin e mesëm të ulët" ( klasat 6-9)
- Udhëzim nr.14, dt. 10.07.2023 për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e Arsimit Parauniversitar
- Urdhri i Përbashkët për miratimin e strukturës së vitit shkollor 2026-2027 në sistemin arsimor parauniversitar (Miratimi i Strukturës së Vitit Shkollor 2026-2027 në Sistemin Arsimor Urdhër Nr.110, datë 21.04.2026.)
- Udhëzim i Përbashkët Nr. 15 Datë 18.08.2026 Për Vitin Shkollor 2026-2027 Në sistemin Arsimor Parauniversitar.

**KRYETARI I BORDIT**

Ema ARBANA

**Drejtori i Shkollës**

Suada KROI